

SWISS APPROVAL ALBANIA shpk Adresa: Rr. "Sami Frasheri", Nr. 19, H. 8, 1019 Tirane, Albania Tel.: +355 44309515 Cel.: +355 697073002 www.swissapproval.al info@swissapproval.al	Rish. nr. 2 Data: 28.09.2020	Kodi CO-SAA-08-01	Faqe 1 nga 5
--	---------------------------------	----------------------	-----------------

Përshkrim i shkurtër i skemës së certifikimit për personat që punojnë me pajisjet/instalimet nën presion

1. HYRJE

Kjo skeme certifikimi është prone e shoqërisë SWISS APPROVAL ALBANIA sh.p.k.

Është përgjegjësi e shoqërisë të hartojë dhe mirëmbajë skemën e certifikimit, të marre miratimin e të gjitha palëve të interesuara për këtë skeme, ta vlerësojë atë në mënyrë të vazhdueshme, ta zbatojë atë, të ndryshojë skemën dhe të njoftojë të gjithë personat e certifikuar për ndryshimet.

Certifikimi për personelin është një shërbim që ofrohet nga trupa certifikuese SWISS APPROVAL ALBANIA Shpk kundrejt pagesës, tarifit për shërbimin publikohen pranë trupës certifikuese.

2. QELLIMI, OBJEKTI I ÇERTIFIKIMIT

Objekti i certifikimit është që të dëshmojë nëpërmjet certifikatës se personat mbajtës të certifikatës janë të kualifikuar dhe me kompetencë në fushën përkatëse, pasi kanë kaluar me sukses të gjitha kërkesat e kësaj skeme certifikimi.

Certifikimi ka objektive që të garantojë "tregun e punës" për kompetencat e personave të certifikuar.

Kjo skeme i adresohet të gjithë personave që punojnë ose duan të punojnë në vendosjen në punë/shfrytëzim, heqjen nga puna, përdorimin, transportimin, riparimin, modifikimin apo mirëmbajtjen e pajisjeve / instalimeve nën presion.

3. REFERENCA NORMATIVE

Objekti i certifikimit bazohet në referencat normative:

- EN ISO/IEC 17024:2012 "Kërkesa të përgjithshme për trupat që bëjnë certifikimin e personave".
- VKM nr.425, datë.20.05.1996 "Rregulloren për Prodhimin, Instalimin dhe Shfrytëzimin e Rezervuarëve të Gazit të Lëngëzuar të Naftës"
- "Rregullore e pajisjeve nën presion të trajtimit të GLN-së" Tiranë 1999
- "Rregullore e sigurimit teknik të kaldajave të avullit dhe ujit të nxehtë" Tiranë 1988
- "Rregullores për shfrytëzimin e kaldajave të avullit Tiranë 1984"
- Standardi S SH EN ISO 21009-2 : 2015 "Enët nën presion kriogjenike. Enët statike të termoizoluara me vakum. Kërkesat e shfrytëzimit"
- "Rregulloren projektimin, vendosjen, shfrytëzimin dhe riparimin e pajisjeve nën presion", Tiranë 1984
- Kapitulli 8.2 të ADR "Kërkesa lidhur me trajnimin e ekipit të mjetit".
- LIGJI Nr. 32/2016 "Për garantimin e sigurisë së punës të pajisjeve dhe instalimeve nën presion
- Vendim Nr. 1062, datë 23.12.2015 Për miratimin e rregullit teknik "Për pajisjet dhe bashkësitë nën presion" dhe përcaktimin e listës së standardeve të harmonizuara
- Vendim Nr. 1065, datë 23.12.2015 Për miratimin e rregullit teknik "Enët e thjeshta nën presion" dhe përcaktimin e listës së standardeve të harmonizuara

4. GRUPET E CERTIFIKIMIT

Klasifikim i grupeve:

Grupi A. Përdorues/operues/shfrytëzues të rezervuarëve/instalimeve të GLN-së me vëllim deri 13 m3 mbi/nën tokë;

Grupi B. Përdorues/operues/shfrytëzues të rezervuarëve/instalimeve të GLN-së me vëllim mbi 13 m3, mbi/nën tokë;

Grupi C. Përdorues/operues/shfrytëzues të enëve/instalimeve nën presion të pajisjeve teknologjike dhe rezervuarëve të ajrit;

Grupi D. Përdorues/operues/shfrytëzues të kaldajave me avull dhe me ujë/vaj të nxehtë;

Grupi E. Përdorues/operues/shfrytëzues të enëve/instalimeve nën presion kriogjenike;

Grupi F. Përdorues/operues të instalimeve të qendrave të mbushjes dhe të magazinimit të bombolave me GLN;

Grupi G. Përdorues/operues për shkarkimin dhe transvazimin së cisternave automobilistike/hekurudhore të GLN;

<p>SWISS APPROVAL ALBANIA shpk Adresa: Rr. "Sami Frasheri", Nr. 19, H. 8, 1019 Tirane, Albania Tel.: +355 44309515 Cel.: +355 697073002 www.swissapproval.al info@swissapproval.al</p>	<p>Rish. nr. 2 Data: 28.09.2020</p>	<p>Kodi CO-SAA-08-01</p>	<p>Faqe 2 nga 5</p>
---	--	---------------------------------------	----------------------------------

Grupi H. Persona që kanë për detyre dhe përgjigjen për transportin e bombolave të GLN-së dhe instalimin e tyre tek konsumatori;

5. KUSHTET PARAPRAKE

Kandidati, që dëshiron të certifikohet ne cilin do nga grupet e kësaj skeme, duhet të përmbushi parakushtet për certifikim fillestar ose ricertifikim të përcaktuara meposhte:

- Të ketë mbushur moshën 18 vjeç, duke e dëshmuar me një dokument identifikimi të vlefshëm.
- Të ketë mbaruar shkollën 8/9 vjeçare (Arsimin e Detyruar), duke e dëshmuar me një dokument të lëshuar nga autoritetet përkatëse. (diplome, dëftesë, vërtetim etj.)
- Të plotësojë kërkesat e aftësive fizike sipas pikës 5. të kësaj skeme certifikimi si shikimi; dëgjimi; lëvizshmëria, dëshmuar me një dokument të lëshuar nga autoritetet mjekësore kompetente dhe te jete jo meevjeter se nje vit.
- Të kenë kryer të paktën një trajnim nga pune dhënësi apo subjekt tjetër, i lidhur me detyrat e grupit per te cilin do te aplikojë ose të ngjashme, dëshmuar me një dokument pjesëmarrje në trajnim.
- Të kenë të paktën 1 (një) vit eksperiencë pune me pajisjet/instalimet nen presion ose te ngjashme, duke e dëshmuar me një dokument. (Libreza e punës, vërtetim/referencë nga pune dhënësi etj.)

Shënim: Kandidati duhet të zotëroj gjuhen shqipe në të shkruar dhe të folur. Në rastet kur kandidati është i huaj, organi certifikues mund të sigurojë përkthimin, nëse do ketë kosto shtese do përballohet nga kandidati.

6. KOMPETENCË E KËRKUAR

Kompetenca kuptohet si ndërthurja e njohurive teorike me aftësitë praktike.

Kjo skeme certifikimi kërkon që kandidati që dëshiron të certifikohet ne një nga grupet e kësaj skeme, të zotërojë kompetencën e domosdoshme.

6.1. Kandidatëve dhe mbajtësve të certifikatave të Grupi A i kërkohet:

- Të njohin dhe të zbatojnë rregullat e përgjithshme të sigurimit teknik dhe pajimet mbrojtëse personale.
- Të njohin dhe të zbatojnë rregullat e sigurimit teknik për pajisjet nen presion.
- Të njohin gazin e lëngëzuar të naftës (GLN), vetite kimike dhe fizike, dhe rreziqet qe rrjedhin prej tij.
- Njohurite e duhura, si dhe dëshmitë ose dëftesat arsimore nga autoritetet përkatëse.
- Të njohin skemën teknologjike të funksionimit, komponentët e saja dhe parametrat teknik të punës për rezervuarët dhe instalimet përkatës të GLN
- Të njohin aksesoret e sigurisë, aksesoret e matjes dhe aksesoret e funksionimit, parimin e punës dhe funksionin e tyre.
- Kryerja e trajnimit nga punëdhënësi ose një subjekt tjetër lidhur me detyrat e grupit A.
- Familjarizimi me përdorimin e pajisjeve/instalimeve të GLN përfshirë instalimet ndihmëse, dhe përvojën praktike me detyrat e grupit A.
- Njohjen e procedurave standarde për furnizimin me GLN ne mënyrë të sigurt të automjeteve ose konsumatorëve përkatës
- Të kenë njohuri mbi mbrojtjen nga zjarri dhe të dine të veprojnë ne rast zjarri.

6.2. Kandidatëve dhe mbajtësve të certifikatave të Grupi B i kërkohet:

- Të njohin dhe të zbatojnë rregullat e përgjithshme të sigurimit teknik dhe pajisjet mbrojtëse personale.
- Të njohin dhe të zbatojnë rregullat e sigurimit teknik për pajisjet nen presion.
- Të njohin gazin e lëngëzuar të naftës (GLN) vetit kimike dhe fizike, dhe rreziqet qe rrjedhin prej tij.
- Njohurite e duhura, si dhe dëshmitë ose dëftesat arsimore nga autoritetet përkatëse
- Të njohin skemën teknologjike të funksionimit, komponentët e saja dhe parametrat teknik të punës për rezervuarët dhe instalimet përkatës të GLN
- Të njohin aksesoret e sigurisë, aksesoret e matjes dhe aksesoret e funksionimit, parimin e punës dhe funksionin e tyre.
- Kryerja e trajnimit nga punëdhënësi ose një subjekt tjetër lidhur me detyrat e grupit B.

- Familjarizimi me përdorimin e pajisjeve/instalimeve të GLN përfshirë instalimet ndihmëse, dhe përvojën praktike me detyrat e grupit B.
- Njohja e procedurave standarde për furnizimin me GLN në mënyrë të sigurt të automjeteve ose konsumatorëve përkatës, përfshirë qendrat e depozitimit për tregtim me shumice ose për përdorim vetjak
- Aftësitë për regjistrimin e shënimeve në librin e marrjes dhe të dorëzimit të ndërresës.
- Të kenë njohuri mbi mbrojtjen nga zjarri dhe të dine të veprojnë në rast zjarri.

6.3. Kandidatëve dhe mbajtësve të certifikatave të Grupi C i kërkohet:

- Të njohin dhe të zbatojnë rregullat e përgjithshme të sigurimit teknik dhe pajisjet mbrojtëse personale.
- Të njohin dhe të zbatojnë rregullat e sigurimit teknik për pajisjet nën presion.
- Të njohin enët/pajisjet/instalimet nën presion, parimin e punës, parametrat e punës dhe rreziqet që lidhen me to.
- Njohuritë e duhura, si dhe dëshmitë ose dëftesat arsimore nga autoritetet përkatëse
- Të njohin skemën teknologjike të funksionimit dhe komponentët e sajë për pajisjet/instalimet nën presion.
- Të njohin aksesoret e sigurisë, aksesoret e matjes dhe aksesoret e funksionimit, parimin e punës dhe funksionin e tyre.
- Kryerja e trajnimit nga punëdhënësi ose një subjekt tjetër lidhur me detyrat e grupit C.
- Familjarizimi me përdorimin e pajisjeve/instalimeve nën presion, pajisjeve ndihmëse dhe me përvojën praktike në detyrat e grupit C.
- Njohjen e procedurave standarde ndaljen dhe vënien në punë të pajisjeve/instalimeve nën presion në mënyrë të sigurt.
- Aftësitë për regjistrimin e shënimeve në librin e marrjes dhe të dorëzimit të ndërresës.

6.4. Kandidatëve dhe mbajtësve të certifikatave të Grupi D i kërkohet:

- Të njohin dhe të zbatojnë rregullat e përgjithshme të sigurimit teknik dhe pajisjet mbrojtëse personale.
- Të njohin dhe të zbatojnë rregullat e sigurimit teknik për kaldajat dhe pajisjet nën presion.
- Kualifikimet e duhura, si dhe dëshmitë ose dëftesat arsimore nga autoritetet përkatëse
- Të dine parimin e punës për kaldajat me avull ose ujë/vajë të nxehtë, procedurat për lëshimin në punë, ndaljen dhe parametrat teknik të punës së kaldajave.
- Të njohin skemën dhe elementet përbërës të kaldajave, dispozitivët/aksesoret e sigurisë, matjes, funksionimit, parimin e punës dhe funksionin e tyre.
- Familjarizimi me përdorimin e kaldajave dhe instalimet ndihmëse, përvojën praktike në detyrat e grupit C.
- Aftësitë për regjistrimin e shënimeve në librin e marrjes dhe të dorëzimit të ndërresës.
- Të kenë njohuri mbi mbrojtjen nga zjarri dhe të din të veprojnë në rast zjarri.

6.5. Kandidatëve dhe mbajtësve të certifikatave të Grupi E i kërkohet:

- Të njohin dhe të zbatojnë rregullat e përgjithshme të sigurimit teknik dhe pajisjet mbrojtëse personale.
- Të njohin dhe të zbatojnë rregullat e sigurimit teknik për pajisjet nën presion dhe enët kriogjenike.
- Kualifikimet e duhura, si dhe dëshmitë ose dëftesat arsimore nga autoritetet përkatëse
- Të njohin fluidet kriogjenike dhe vetitë e tyre, enët kriogjenike dhe rreziqet që vijnë prej tyre.
- Të njohin skemën teknologjike të enëve dhe instalimeve përkatës kriogjenike dhe parametrat teknik të punës.
- Të njohin dispozitivët/aksesoret e sigurisë, matjes, funksionimit, parimin e punës dhe funksionin e tyre, përfshirë edhe shkarkimin e presionit.
- Të kenë njohuri mbi ndërtimin e enëve kriogjenike me vakum dhe komponentët kryesor të instalimit kriogjenik.
- Familjarizimin me përdorimin e enëve/instalimeve kriogjenike, dhe përvojën praktike me detyrat e grupit E.
- Njohjen e procedurave standarde për furnizimin në mënyrë të sigurt të enës ose konsumatorëve përkatës.
- Aftësitë për regjistrimin e shënimeve në librin e marrjes dhe të dorëzimit të ndërresës.
- Të kenë njohuri mbi mbrojtjen nga zjarri dhe të din të veprojnë në rast zjarri.

<p>SWISS APPROVAL ALBANIA shpk Adresa: Rr. "Sami Frasheri", Nr. 19, H. 8, 1019 Tirane, Albania Tel.: +355 44309515 Cel.: +355 697073002 www.swissapproval.al info@swissapproval.al</p>	<p>Rish. nr. 2 Data: 28.09.2020</p>	<p>Kodi CO-SAA-08-01</p>	<p>Faqe 4 nga 5</p>
---	--	---------------------------------------	----------------------------------

6.6. Kandidatëve dhe mbajtësve të certifikatave të Grupi F i kërkohet:

- Të njohin dhe të zbatojnë rregullat e përgjithshme të sigurimit teknik dhe pajisjet mbrojtëse personale.
- Të njohin dhe të zbatojnë rregullat e sigurimit teknik për pajisjes nen presion.
- Të njohin gazin e lëngëzuar të naftës (GLN) vetit kimike dhe fizike, dhe rreziqet qe rrjedhin prej tij.
- Kualifikimet e duhura, si dhe dëshmitë ose dëftesat arsimore nga autoritetet përkatëse
- Të njohin skemën teknologjike të instalimit për mbushjen e bombolave, komponentët e saja dhe parametrat teknik.
- Të dine dhe të kryejnë kontrollet e duhura të bombolave qe do të mbushen me GLN
- Të njohin aksesoret e sigurisë dhe aksesoret e matjes, parimin e punës dhe funksionin e tyre.
- Kryerjen e trajnimit nga punëdhënësi ose subjekt tjetër lidhur me detyrat e grupit F.
- Familjarizimin me impiantin e mbushjes së bombolave të GLN përfshirë instalimet ndihmëse, dhe përvojën praktike me detyrat e grupit F.
- Njohjen e procedurave standarde për mbushjen e bombolave me GLN ne mënyrë të sigurt, përfshirë.
- Aftësitë për regjistrimin e shënimeve në librin e marrjes dhe të dorëzimit të ndërresës.
- Të kenë njohuri mbi mbrojtjen nga zjarri dhe të din të veprojnë ne rast zjarri.

6.7. Kandidatëve dhe mbajtësve të certifikatave të Grupi G i kërkohet:

- Të njohin dhe të zbatojnë rregullat e përgjithshme të sigurimit teknik dhe pajisjet mbrojtëse personale.
- Të njohin dhe të zbatojnë rregullat e sigurimit teknik për pajisjet nen presion.
- Të njohin gazin e lëngëzuar të naftës (GLN) vetit kimike dhe fizike, dhe rreziqet qe rrjedhin prej tij.
- Kualifikimet e duhura, si dhe dëshmitë ose dëftesat arsimore nga autoritetet përkatëse
- Të njohin skemën teknologjike të funksionimit, komponentët përbërës të saja dhe parametrat teknik të punës për instalimet e transvazimit të GLN me të dy mënyrat, me pompe dhe me kompresor.
- Të njoh aksesoret e sigurisë dhe aksesoret e matjes, parimin e punës dhe funksionin e tyre.
- Kryerjen e trajnimit nga punëdhënësi ose subjekt tjetër lidhur me detyrat e grupit G.
- Familjarizimin procesin e transvazimit të GLN përfshirë instalimet ndihmëse, dhe përvojën praktike me detyrat e grupit G.
- Njohjen e procedurave standarde dhe zbatimin e tyre për transvazimin e GLN ne mënyrë të sigurt ne shkarkim ose ngarkim.
- Aftësitë për regjistrimin e shënimeve në librin e marrjes dhe të dorëzimit të ndërresës.
- Të kenë njohuri mbi mbrojtjen nga zjarri dhe të din të veprojnë ne rast zjarri.

6.8. Kandidatëve dhe mbajtësve të certifikatave të Grupi H i kërkohet:

- Të njohin dhe të zbatojnë rregullat e përgjithshme të sigurimit teknik dhe pajisjet mbrojtëse personale.
- Të njohin dhe të zbatojnë rregullat e sigurimit teknik për enët nën presion.
- Të njohin gazin e lëngëzuar të naftës (GLN) vetit kimike dhe fizike, dhe rreziqet qe rrjedhin prej tij.
- Njohuritë e duhura, si dhe dëshmitë ose dëftesat arsimore nga autoritetet përkatëse
- Të njohin dhe të zbatojnë kushte teknike për ngarkimin/shkarkimin dhe transportimin e sigurt të bombolave të GLN.
- Kryerjen e trajnimit nga punëdhënësi ose subjekt tjetër lidhur me detyrat e grupit H.
- Të njohin dhe të zbatojnë kushtet teknik për instalimin e bombolave të GLN të konsumatori.
- Njohja e automjetit dhe kushteve teknike qe kërkohen për nje transport të sigurt te bombolave të GLN, dhe sinjalistika përkatëse qe përdoret.
- Aftësitë për regjistrimin e shënimeve në librin e marrjes dhe të dorëzimit të bombolave.
- Të kenë njohuri mbi mbrojtjen nga zjarri dhe të dine të veprojnë ne rast zjarri.

7. PËRDORIMIN I CERTIFIKATAVE

Certifikata e leshuar nepermjet kesaj skeme certifikimi ka nje vlefshmeri prej 5 vjetesh dhe rikonfirmim te ruajtjes se kompetences cdo vit.

SWISS APPROVAL ALBANIA shpk Adresa: Rr. "Sami Frasheri", Nr. 19, H. 8, 1019 Tirane, Albania Tel.: +355 44309515 Cel.: +355 697073002 www.swissapproval.al info@swissapproval.al	Rish. nr. 2 Data: 28.09.2020	Kodi CO-SAA-08-01	Faqe 5 nga 5
--	---------------------------------	----------------------	-----------------

Në certifikatën e lëshuar nga organizmi certifikimit dokumentohen konditat për përdorimin e saj dhe te drejtat për menaxhimin e përdorimit dhe përfaqësimit si duhet. Organizmi certifikimit në "Marrëveshja me personin e certifikuar", kodi OC-SAA-09-12, kërkon që personi i certifikuar të pranoj që:

- do të plotësoj përcaktimet përkatëse të skemës së certifikimit përfshirë çdo ndryshim të mundshëm të saj;
- të bëjë pohime lidhur me certifikimin vetëm për fushën për të cilën i është dhënë certifikimi;
- të mos përdorë certifikimin në mënyrë të tillë që të mos e çojë organizmin e certifikimit në diskreditim, dhe të mos bëjë ndonjë deklaram lidhur me certifikim që organizmi i certifikimit e konsideron çorientues ose të pa autorizuar;
- të mos vazhdojë të përdorë të gjitha pohimet për certifikim që përmbajë përmendje të organizmit të certifikimit ose certifikim në pezullim ose anulim të certifikimit dhe të kthejë certifikatat e lëshuara nga organizmi i certifikimit;
- të mos përdorë certifikatën në mënyrë çorientuese.

Shkelja e parashikimeve të kësaj marrëveshje përbën shkak për nisjen e procedurës së pezullimit dhe/ose revokimit të certifikatës. Organizmi certifikimi trajton, me anën e masave korrigjuese, çdo keqpërdorim të certifikimit.

8. KRITERET DHE METODAT E MBIKËQYRJES

8.1. Dëshmimi i përvitshëm për konfirmimin e vlefshmërisë së certifikimit

Përdoruesit e pajisjeve/instalimeve nën presion, mbajtës të certifikimit nga organizmi certifikues SWISS APPROVAL ALBANIA Shpk, dëshmohen çdo vit për të konfirmuar që mbajtësi i certifikatës punon në pajtim me kërkesat e kësaj skeme certifikimi.

8.2. Kriteret e mbikëqyrjes:

Kriteret që duhet të plotësojë personi i certifikuar, për mbikëqyrjen (verifikimi vjetor) janë:

- mbajtësi i certifikatës punon brenda fushës, për të cilin është certifikuar;
- të zotërojë aftësitë fizike referuar pikës 5. të kësaj skeme certifikimi. (mbajtësi i certifikatës dorëzon një dokument të lëshuar nga organet kompetente mjekësore të vlerësimit të aftësive fizike);
- verifikon që në aktet e inspektimit të autoriteteve përgjegjëse, ISHTI, Inspektorati Shtetëror i Punës dhe organeve të tjera kompetente, nuk ka detyra të parealizuara, gjatë ushtrimit të aktivitetit të tij si operator i pajisjeve/instalimeve nën presion;
- verifikohet kryerja e trajnimit vjetor, brenda fushës së skemës së certifikimit;
- personi i certifikuar nuk duhet të ketë shkëputje më të madhe se 6 muaji nga ushtrimi i aktivitetit të punës sipas grupit përkatës. (mbajtësi i certifikatës dorëzon një dokument vërtetues)
- zhvillimi dhe ngritja profesionale. (mbajtësi i certifikatës dorëzon një dokument që dëshmon kryerjen e një trajnimit vjetor për sigurinë dhe përdorimin e pajisjeve nën presion të fushës së certifikimit)
- të kalojë me sukses intervistën e strukturuar, nga grupi i mbikëqyrjes i miratuar për këtë qëllim)

9. ANKESAT DHE APELIMET

Kandidati ose personi i certifikuar ka te drejte te apeloje vendimet e marre nga organi certifikues SWISS APPROVAL ALBANIA shpk. Apelimi do te depozitohet tek organi certifikuese jo me vone se 10 dite nga komunikimi i marrjes së vendimit.

Procedura e vlerësimit, hetimit dhe trajtimit të apelimit do të ndiqet sipas procedurës me kod CO-SAA-09-30 dhe Forma e apelimit jepet sipas CO-SAA-09-29.

Kandidati, personi i certifikuar apo çdo person tjetër ka te drejte te ankohet ne lidhje me aktivitetin certifikues te SWISS APPROVAL ALBANIA shpk ose me aktivitetin e personit te certifikuar ne lidhje me certifikimin sipas kësaj skeme

Ankesat do te depozitohen me shkrim sipas formës CO-SAA-09-29 tek trupa certifikuese SWISS APPROVAL ALBANIA shpk.

10. KJO SKEME CERTIFIKIMI ËSHTË PRONË E "SWISS APPROVAL ALBANIA" Shpk